



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.573/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Rivlerësimi i propozimit teknik për bashkimin e operatorëve ekonomikë “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk procedurës së prokurimit “Shërbim Konsulence”, me nr.REF-67204-07-28-2020, me objekt “*Studim Projektim zgjerim i segmentit rrugor, dalje Elbasan – Perenjës – Qafe Thane*” me fondin limit 53.369.587,32 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 18.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar
- Ankimues:** BOE “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk  
Blv “Zogu i I”, Pallati i ri 12 katësh, Ap.8-3 pranë Cirkut Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Rr.Sami Frashëri Nr.33, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i

Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Shërbim Konsulence”, me nr.REF-67204-07-28-2020, me objekt “Studim Projektim zgjerim i segmentit rrugor, dalje Elbasan – Perenjas – Qafe Thane” me fondin limit 53.369.587,32 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 18.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 8510/1 datë 10.11.2020 rezulton se në datën 12.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se janë kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë vijon:

- |  |               |
|--|---------------|
| - Infratransprojekt  | kualifikohet  |
| - IYRIAN consulting engineer   | kualifikohet  |
| - Geosat Group   | skualifikohet |
| - Infrakonsult   | kualifikohet  |
| - A& E Engineering   | kualifikohet  |
| - Unitec-Studio  | skualifikohet |
| - Archispace   | skualifikohet |
|  |               |
| - 47EK79”& Iliriada P.K.S & “SRP Albanian Engeneering” & “C.E.C” Group | kualifikohet  |
|  |               |
| - Net Group shpk   | skualifikohet |
| - D& C PARTNERS  | kualifikohet  |
| - Gjeokonsul &CO   | kualifikohet  |
| - SEED Consulting  | kualifikohet  |

II.3. Referuar informacionit sa më sipër rezulton se pas mbylljes dhe në përfundim të afateve të ankimit autoriteti kontraktor me ftesë për propozim nr.5567/3 prot datë 02.09.2020 ka njoftuar BOE “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk për dorëzimin e propozimit teknik. Ftesa për dorëzimin e propozimit ju është dërguar edhe kandidatëve të kualifikuar cituar më lart. Afati kohor për hapjen e propozimeve teknike në ftesën për ofertë është data 18.09.2020 ora 11:00.

Në datën 18.09.2020 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozimeve teknike dhe ekonomike.

II.4. Në datën 05.10.2020 KVO-ja përfundoi vlerësimin e propozimeve teknike të ofertuesve të kualifikuar si më poshtë:

BOE “Gjeokonsult & CO” shpk

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të p22.5ropozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	9	22.5	47+10		88.5
2	9	22.5	47+10		89.1
3	9	22.5	46.5+10		88

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 88.533 pikë (tabela bashkëlidhur)

#### BOE “A&E Engineering”

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të p22.5ropozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	9	24	46+10		89
2	9	24.3	45+10		88.3
3	9	24.9	45+10		88.9

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 88.733 pikë (tabela bashkëlidhur)

#### OE “Infrakonsult”

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të p22.5ropozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	9	26.1	47+10		92.1
2	9	26.1	47+10		92.1
3	9	25.8	47+10		91.8

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 92 pikë (tabela bashkëlidhur

#### BOE - 47EK79”& Iliriada P.K.S

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të propozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	9	22.5	46.5+10		88
2	9	23.1	46.5+10		88.6
3	9	22.8	45.5+10		87.3

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 87.967 pikë (tabela bashkëlidhur

#### BOE D& C PARTNERS

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të p22.5ropozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	8	21.9	45+10		84.9
2	8	22.2	45+10		85.2
3	8	21.9	45+10		84.9

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 85 pikë (tabela bashkëlidhur

#### Infratransprojekt

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të p22.5ropozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	9	24.9	45+10		88.9
2	9	25.2	45+10		89.2
3	8.5	25.2	45+10		88.7

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 88.933 pikë (tabela bashkëlidhur

#### OE SEED Consulting

Anëtari i KVO-së	Përvoja në punë të ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-30	Stafi kryesor të p22.5ropozuara	Transferimi i njohurive nuk kërkohet 0	Total
1	8	24	45+10		87
2	8	24	45+10		87
3	8	24	45+10		87

Duke pasur parasysh që në tabelën e mësipërme nuk kërkohet vlerësimi 0-10 pikë, për transferimin e njohurive pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteriduhet ti shtohet kriterit “Kualifikimet e stafit kryesor të prpozuar”

Pas vlerësimit individual me kriter pikëzimi nga 0 në 100, operatori i mësipërm u vlerësua me pikët mesatare 87 pikë (tabela bashkëlidhur

II.5. Në datën 12.10.2020, BOE “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, me pretendimet si më poshtë:

*[...] Nga ana e KVO –së jemi vlerësuar me pikë si më poshtë*

*Totali i pikëve mësatore 87.967 pikë e ndarë në*

*Përvoja në punë të ngjashme (mesatare) 9.000 pikë*

*Metodologjia e propozuar (mesatare) 22.800 pikë*

*Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar (mesatare) 56.167 pikë.*

*Bazuar në përvojën në punë të ngjashme metodologjinë e prpozuar dhe kuaifikmet e stafit kryesor të propozuar nga na jonë ne kundështojmë vlerësimin e bërë nga KVO-ja pasi BOE “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk duhej të vlerësohej me pikët maksimale për:*

*Përvojë për punë të ngjashme (vlerësimi nuk duhet të jetë subjektiv, por objektiv bazuar në DST dhe në LPP-në.*

*Metodologjia e propozuar*

*Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.*

II.6. Në datën 19.10.2020 nëpërmjet shkresës me nr.7608/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 27.10.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 8510/1 prot., datë 10.11.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr.1359/2 datë 12.11.2020 me objekt “*Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Studim Projektim zgjerim i segmentit rrugor, dalje Elbasan – Perenjash – Qafe Thane”*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “47EK79”& “Iliriada P.K.S” shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk për kundërshtimin e vlerësimit të propozimit teknik të këtij të fundit dhe rivlerësimin e tij Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike konsulente, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përfshirë llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë”*.

III.1.2. Në nenin 37 “Shërbimet e konsulencës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Shërbim konsulente është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP-së, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.*

ii. Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:  
- përvojën e konsulentit; - cilësinë e metodologjisë së propozuar; - kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; - transferimin e njohurive, nëse kërkohet. *“Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t’i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar”*.

*Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 e, më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.*

*Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.*

*“Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij”.50*

*Autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti kontraktornjofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim dhe i kthen të pahapura propozimet ekonomike. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.*

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 5, pika 5.1. *“Autoriteti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e References, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse*



Dokumentat e Tenderit parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.

III.1.4. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 5, pika 5.5. “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

### ***Kriteret e vlerësimit***

5.5 Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

<b><i>Kriteret e Vlerësimit</i></b>	<b><i>Pikët</i></b>
(i) <i>Përvoja per Pune te Ngjashme te Konsulentit</i>	<i>[0-10]</i>
<b><i>Nënkriteret</i></b>	
<b><i>i/a Përvoja për punë të ngjashme</i></b>	<b><i>40-80%</i></b>
<i>Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.</i>	
<b><i>i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%</i></b>	
<i>Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.</i>	
<i>Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.</i>	
(ii) <b><i>Metodologjia e Propozuar</i></b>	<b><i>[20-30]</i></b>
<b><i>Nënkriteret</i></b>	
<i>ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia</i>	<i>[20-30%]</i>
<i>ii.b Plani i punës dhe grafiku u dorëzimit të projektit</i>	<i>[30-40%]</i>
<i>ii.c. Organizimi i Stafit</i>	<i>[20-30%]</i>
<b><i>ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që</i></b>	

propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlikohjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përfaqshjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave te Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

**ii/c. Organizimi dhe Staf:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

b. Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencë.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

**(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]**

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atehëre pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

**Total (Propozimi Teknik) 100%**

- **Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

*Pe*- Pikët për Propozimin Ekonomik

*Çu*- Çmimi më i Ulët i Ofruar

*Ç* – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik:  $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$**

**Pesha për Propozimin Ekonomik:  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Operatori ekonomikë që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

III.1.5. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3. “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatorëve ekonomikë i është kërkuar përmbushja e kushteve si më poshtë:

### **2.3.1 Përvoja e mëparshme:**

Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit të kontratës që prokurohet, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

*\*Kjo të vërtetohet me kopje të kontratave / vërtetim / çertifikatë / çdo dokument që jep të dhëna mbi cilësinë e kryerjes së shërbimit, të lëshuar nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohet, fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara .*

*\*Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.*

*2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues, teknik të shoqërisë, të afte për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas termave të referencës, për këtë objekt.*

- Drejtuesin e projektit ,( **inxhinier ndertimi** ) , me eksperience pune jo më pak se 15 vjete*
- **Inxhinier ndertimi** minimumi **1 (nje)**, me eksperience pune jo më pak se 10 vjete*
- **Inxhinier topografike** minimumi **1 (nje)** , me eksperience pune jo më pak se 5 vjete*
- **Inxhinier elektrik** minimumi **1(nje)**, me eksperience pune jo më pak se 5 vjete*
- **Inxhinier gjeolog** minimumi **1(nje)**, me eksperience pune jo më pak se 10 vjete*
- **Inxhinier hidroteknik** minimumi **1(nje)**, me eksperience pune jo më pak se 10 vjete*
- **Inxhinier mjedis** minimumi **1(nje)**, me eksperience pune jo më pak se 5 vjete*

*Listes se stafit drejtues, teknik duhet të bashkelidhen për secilin, Diploma, licenca profesionale, CV-të, kontra noteriale e punës,*

*\*Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

*III.1.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar që disiplinon shërbimin e konsulencës, ku parashikohet se në tërësi propozimi teknik i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve*

kryesorë, të tillë si përvoja e konsulentit, kualifikimi i stafit të propozuar si dhe metodologjia e propozuar nga operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës, si dhe duke pasur parasysh të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik në analize të projekteve teknike të dorëzuar në këtë procedurë prokurimi, konstaton se në lidhje me eksperiencat e mëparshme BOE ankimues “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- *Profili i kompanisë ku ka paraqitur Eksperiencat e shoqërisë “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk si vijon:*
- *Projekti Studim projektim dhe Supervizion për Rikonstruksionin e 45 shkollave në të gjithë Shqipërinë*
- *Projekti Studim projektim për rikonstruksionin e 10 kopshteve në Qytetin e Tiranës*
- *Projekti i Stabilizimit të Rrëshqitjes në Segmentin Tiranë Krrabë*
- *Projekti i Ujësjetësimit Rajonal Maqellarë Dibër*
- *Projekti i Ujësjetësimit Rajonal Malësi e Madhe Rrëshen Klos*
- *Projekti i zbatimit të rikonstruksionit të rrugës kryesore Kamëz , Rrjetit të Kanalizimeve të Ujrave të zeza, Furnizimit me ujë të Pijshëm, Sistemit Telefonik, Sistemit të ndricimit, të trajtimit të ujrave sipërfaqësore dhe gjelbërimit përgjatë kësaj rruge*
- *Projekti i Stabilizimit të rrëshqitjes në segmentin Romanat Plepa Durrës*
- *Projekti i zbatimit të rrugëve të kanalizimeve të ujrave të zeza , furnizimit me ujë të pijshëm, sistemit telefonik, sistemit të ndricimit , të trajtimit të ujrave sipërfaqësore dhe gjelbërimit për zonat e re urbane të komunës kashar me sipërfaqe 235.5 ha.*
- *Projekti Ndërtimi i paraburgimit i ri në Durrës dhe rikonstruksion i spitalit të sëmurëve mendor me mjekim të detyruar.*
- *Projekti Studim Projektim dhe Projekt zbatimi Rruga Fushë Krujë Milot*
- *Studim projektim fizibiliteti dhe projekt zbatimi By Pass Plepa Kavajë Rrogzhinë*
- *Projekti i Rrugës Tepelenë Vlorë Loti 2*
- *Projekti i Rrugës Ersekë leskovik Loti 2*
- *Projekti i Rrugës Hani i Hotit Vermosh Loti 1*
- *Projekti i Rrugës Kukës Shishtavec*

- *Projekt Zbatimi i rrjetit të Ujësjellësit Kanalizime dhe Mbrojtja Mjedisore e Liqenit të Shkodrës*
- *Projekt zbatimi rruga Hidrocentrali Banjës Gramsh*
- *Projekti Fizibiliteti dhe Projekt Zbatimi i Rrugës Hamdi Cullhaj*
- *Projekti Fizibiliteti dhe Projekt zbatimi i rrugës Gjike Kuqali*
- *Projekti Studimi urbanistik dhe infrastruktura e zonës së Spitalit Tepelenë*
- *Projekti Fizibiliteti dhe Projekt Zbatimi i Rrugës për në sheshin e shpimit Molisht 1-5.*
- *Projekti Studim Projektim Dublimi i aksit Kashar Rinas*
- *Projekti Studim Projektim masa inxhinierike në aksin Vlorë Sarandë dhe Fier Ballsh Tepelenë*
- *Projekti Studim projektim aksi selenicë Kuc Qeparo*
- *Projekti Studim projektim Rruga Skrapar Gramsh*
- *Projekti Supervizion i punimeve Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të Memaliaj Rrjeti shpërndarës*
- *Projekti Shpenzime Supervizion i kontratave të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rajoni Jugor Gjirokastër*
- *Supervizion i punimeve ndërtim Rruga Kardhiq Delvinë Loti 4,5,6.*
- *Supervizion i punimeve ndërtim i linjave të shpërndarjes së qytetit Tepelenë*
  
- *Profil i Kompanisë CEC Group*
- *Referencat Punët e Ngjashme Viti 2010-2012 Në projektim*
- *Projekt zbatimi për ndërtesa banimi +shërbime 3 kate*
- *Hartimi i Projekt Preventivit të objektit Sistemim Asfaltim i Rrugës Dragot Pasarelë Komuna Qendër Tepelenë*
- *Studim projektim hartim projekt zbatimi për rrugët rurale Zapod Rruga Nacionale 2 Pac berishë Lusën Buzemadhe*
- *Studim projektim i rrugës lidhëse Kucovë Kozarë*

- *Studim projektim i rrugës Kozarë Ura e Plakës*
- *Studim projektim ujësjellësi fshati Melgushe faza II Komuna Bushat.*
- *Supervizion për mirëmbajtje të autostradës Milot Kalimash*
- *Mbikqyrje punimesh në objektin Rikonstruksion në fakultetin e Mjeksësisë të UT*
- *Mbikqyrje punimesh në objektin Rikonstruksion i godinës së DRSSH Tiranë*
- *Mbikqyrje punimesh në objektin Rikonstruksion i Rrugës Qafë e Koshavicës Cakran*

*Viti 2013*

- *Studim projektim riveshje me asfalt shëtitorja Nënë Tereza*
- *Projektzbatim për ndërtesë banimi shërbime 11 kate*
- *Mbikqyrje punimesh për Ndërtim i spitalit të ri Psikiatrik Ali Mihali Vlorë*
- *Mbikqyrje punimesh Riveshje pjesore e segmentit rrugor dalje Klos kryqëzim rruga e Bllatës loti I*
- *Mbikqyrje punimesh Riveshje segmenti rrugor Shinat e Trenit Fier levan Rruga hyrëse Autosdrada Levan Vlorë*
- *Mbikqyrje punimesh në objektin ndërtim i shesheve operationale të kalatës së re pranë Autoritetit Portual Shëngjin*
- *Supervizion i Mbikqyrjes punimesh në objektin ndërtim objekti 3k+2k podrume një investim privat në komunën farkë ku totali i ndërtimit arin në 6000 m2.*

*Viti 2014*

- *Projektzbatim për reabilitimin e qendrës dhe bulevardit lyerja e fasadave sistemim unaza e sipërme ekzistuese ndërtim unaza e poshtme Qyteti i Vjetër Bashkia Bulqizë.*
- *Projekt zbatimi për ndërtesa banimi shërbimi 11 kate*
- *Studim urbanistic Resort Turistik Golem*
- *Studim urbanistic Resort Turistik Fier*
- *Restaurim i banesës Asllan Muhedini*
- *Restaurim i banesës së familjes Zere*

*Në Mbikqyrje*

- *Mbikqyrje e punimeve dhe rishikim projekti për objektin Rikualifikim i Nënkalimit dhe Rotondës tek ura e Dajlanit dhe në Plepa Durrës*
- *Mbikqyrje e punimeve dhe rihikim projekti për objektin Sheshi dhe rrugicat tek kulla panorama sheshi te Teatri Korcë*
- *Projektim dhe supervizion i objektit Restaurimi i pazarit të vjetër të Korcës Loti 1 loti 2*
- *Mbikqyrje e punimeve për objektin Sistemim Asfaltim rruga Thoma Kalefi*
- *Mbikqyrje e punimeve për objektin Sistemim Asfaltim i rrugës Qemal Stafa, segmenti tek kryqëzimi i rrugës Rinia deri te kryqëzimi me rrugën Kasem sejdini si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet Blv Aqif Pasha dhe Rrugës Qemal Stafa*
- *Mbikqyrje e punimeve për objektin Lyerje dhe suvatime Fasdash në Qendër Blv Aqif Pasha dhe rruga Qemal Stafa*
- *Mbikqyrje e Punimeve për objektin Rikonstruksion i Parkut Rinia*

*Viti 2015*

- *Hartim projekt zbatimi për fasadat dhe ambinetet rekreative Sea Land Vlorë*
- *Hartim projekt zbatimi për objektin Ndërtim i Kolektorëve dhe rrjetit të brendshëm të KUZ fshati Kafaraj Komuna Frakull*
- *Hartim projekt zbatimi për objektin Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare fshati Seq Musalaj Komuna Frakull*
- *Hartim projekt zbatimi për objektin Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare fshati Frakull Komuna Frakull*
- *Studim urbanistik Resort Turistik Gjilek Dhërmi*
- *Projekt zbatimi për ndërtesë banimi shërbime 3 kate*
- *Projekt zbatimi për ndërtesë banimi shërbime 10 kate*
- *Projekt zbatimi për ndërtesë banimi shërbime 10 kate*
- *Hartim Projekt Zbatimi Rikonstruksion i Godinës së ZVRPP Elbasan*
- *Projektim i rikonstruksionit të ish godinës së SHIK ish objekti i gjethit*
- *Projekt për rehabilitim urban dhe rindërtimin arkitektonik të fasadave të ndërtesave përgjatë akseve kryesore të zonave pilot*



- *Projektim Restaurim i ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Urban*
- *Projektim i rehabilitimit të bregut të Liqenit të Ohrit*
- *Projektim i Eko Kampus Sarandë*

*Viti 2016*

- *Hartimi i projektit për rikonstruksionin e rrugëve të rajonit të Sotallarëve*
- *Hartim projekti Evidentimi faktit në terren i ndërtimeve pa leje Qarku Shkodër*
- *Hartim projekti Evidentimi faktit në teren i ndërtimeve pa leje Qarku Lezhë*
- *Hartimi i projektit Sistemim i Bllokut të banesave Cermë e Sipërme Divjakë*
- *Projekt zbatim Thellimi i Strugës së Brukes ndërtimi i pasarelës së drurit mbi ishujt artificiale dhe ndërtimi i shëtitores prej druri përgjatë rrugës automobilistike*
- *Hartim projekti Rikualifikim Sistemim Asfaltim rruga Divjakë Gërmenj*
- *Hartim projekti Rikualifikim Sistemim i bllokut të banesave Cermë Shkumbin*
- *Projekt për rehabilitimin urban dhe rindërtim arkitektonik të fasadave të ndërtesave përgjatë akseve kryesore të zonave pilot*
- *Hartim i projektit Rehabilitim i hapsëris së rrethrotullimit të 4 rrugëve Shijak*
- *Hartim projekti Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës për te fabrika e niseshtes Shijak*
- *Hartim projekti Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës në Njësinë Administrative Gjapalaj Shijak*
- *Hartim Projekti Lulishte ambinet clodhës pranë shkollës Muharem Dollaku Shijak*
- *Hartim projekt zbatimi Rikualifikim i Kuartalles Lagje Kodër Shijak*
- *Hartim projekti Rikonstruksion i rrugës 4 rrugët Pjezë Shijak*
- *Rikonstruksion i rrugës dibrës Framacia 10 Oxhaku*
- *Hartim i projektit Ndërtimi i stacionit të pompimit rrjetit të dërgimit dhe rrjetit shpërndarës të ujësjllësit Drashovicë*
- *Hartim projekti Rikonstruksion i rrugës Kryqëzimi Aksi Nacional Sektori 111 Memaliaj*

- *Hartim projekti Sistemim asfaltim i rrugës kam Qafë Prush*
- *Ndërtim i linjës hekurudhore në terminalin perëndimor të portit Durës*
- *Supervizion i objektit rehabilitim i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë segmentit Lin Pogradec*
- *Rikonstruksion i objektit Sistemim dhe asfaltim i rrugës mertish Tre Urat*
- *Supervizion i objektit Rikonstruksion dhe Rivitalizimm i rrugës Gradisht Spolat i Madh*
- *Supervizion i objektit Rikonstruksion i ambienteve në katin e parë dhe të dytë në objektin Inima*
- *Krijimi i një shtegu Trakking në kanionin e Gjipesë*
- *Supervizion i objektit Punime ndërtimore në rrjetin elektrik Agjensia Kavajë Zona Spille Greth*
- *Supervizion i objektit Rivitalizimi i qendrës së qytetit të Rrogozhinës*

*Viti 2017 në projektim*

- *Hartim projekti Rikualifikim asfaltim i rrugës Babunje Agim Bashkia Divjakë*
- *Hartim projekti Rikualifikim i rrugës Ferras Plug Bashkia Divjakë*
- *Hartim projekti Ndërtim i depos tubacionit kryesor dhe rrjetit shpërndarës të ujësllësit Graban Bashkia Divjakë*
- *Hartim projekti Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Grabian Dashkean Shën Kollas*
- *Hartim projekti Sistem Asfaltimi rrugës Peshkepi Treblovë*
- *Hartim projekti Ndërtim projektim i rrugës Selenicë Treblovë*

III.1.7. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar objektit të prokurimit dhe qëllimit të projektit i shprehur qartë në termat e referencës se Objektivi kryesor i projektit: studimi dhe hartimi i një projekti të detajuar i një segmenti rrugor të kategorisë C2 e modifikuar sipas standartit 2015 me gjërësi të pjesës asfaltike 10.5 m dhe dy bankina të paasfaltuara me nga 0.75 m. Projekti i rikonstruksionit do të synojë të përmirësojë cilësinë dhe sigurinë e levizjes.

Referuar vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se BOE ankimues lidhur me komponentin e përvojës së ngjashme ka marrë një vlerësim prej 9 pikësh nga 10 pikë të mundshme.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit,

Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret KPP vëren se BOE ankimues në veprimtarinë e tyre, shfaqin eksperiencë të gjatë në fushën e projektimit dhe hartimit të projekteve të zbatimit dhe në fushën e mbikqyrjes për objekte civile, shkolla ndërtesa, dhe në fushën e projektimit dhe supervizimit në infrastrukturë rrugore dhe për këtë janë vlerësuar nga komisioni shumë afër maksimales me një vlerësim prej 9 pikësh.

KPP gjykon se vlerësimi i dhënë nga specialistët e KVO lidhur me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e projektimit, për BOE ankimues është i arsyeshëm dhe në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ky i fundit.

Në këtë kontekst Komisioni gjykon se vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik prej 9 pikësh është i mjaftueshëm ndërsa argumenti i operatorit ekonomik ankimues për një vlerësim maksimal nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit nuk rezulton të jetë i bazuar. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, një vlerësim i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të mbetet i pandryshuar. Procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me stafin kryesor të propozuar rezulton se nga ana e BOE ankimues është paraqitur dokumentacioni si më poshtë vijon:

- *Deklaratë për stafin kryesor të projektimit sipas detyrave:*
- *Drejtues projekti* *Dhimtraq Konomi*
  
- *Inxhinier Ndërtimi* *Eduard Cela*  
*Vangjush Mbrice*

*Anduen Mbrice*

- *Ing Gjeodet* *Vladimir Pëllumbi*  
*Shehat Murati*
  
- *Ing Elektrik dhe Elektroenergjitik* *Fatbardha Bilali*  
*Andrea Milo*
  
- *Ing Hidroteknik* *Kujtim Cela*  
*Hajri Sula*
  
- *Ing Gjeolog* *Naim Curri*  
*Dritan Kaca*  
*Pellumb Toska*
  
- *Ing Mekanik* *Paskal Jarazi*
- *Arkitekt* *Sotiraq Qirinxi*
- *Specilaist Mjedisi* *Sonila Corapi*  
*Gjergji Lici*
  
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet SRP Albania Engineering në cilësinë e pundhënësit dhe SH.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Ing Gjeodet Drejtues teknik, Deklaratë mbi disponueshmërinë e antarit të stafit.*
  
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet SRP Albania Engineering në cilësinë e pundhënësit dhe H.S në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Ing Hidroteknik, Diplomë, CV, Deklaratë mbi disponueshmërinë e antarit të stafit.*
  
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe A,M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Ing Ndërtimi Drejtues Teknik, Licënë në projektim, librezë pune, certifikatë trajnimi, diplomë, cv*
  
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe P.J në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin Inxhiner Mekanik , Drejtues teknik, Licencë në projektim, Licencë për mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit, diplomë, librezë pune, cv,*
  
- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe Gj.L në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Ing Mjedisi, Drejtues Teknik, Licencë në projektim, Licencë për mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit, librezë pune, certifikatë për VNM, diplomë, cv,*

- *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe S.Q në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Arkitektit dhe Drejtuesit Teknik, Licencë në projektim, diplomë, librezë pune, certifikatë auto cad, cv, letër referencë,*
  - *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe Dh.K në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Ing Ndërtimi dhe të Drejtuesit Teknik, cv, Licencë për mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit,, Licencë në projektim, diplomë, librezë pune,*
  - *Licencë për Mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit A.M, Licencë në projektim Ing Elektroenergjitik, cv*
  - *Cv Gj.S, Ing Ndërtimi*
  - *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe N.H në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Ing Topograf dhe të Drejtuesit teknik, Licencë në Projektim Ing Markshajder, Licencë për mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit, diplomë, librezë pune, cv*
  - *Kontratë Pune lidhur ndërmjet C.E.C Group shpk në cilësinë e pundhënësit dhe V.M në cilësinë e punëmarrësit në pozicionin e Ing Ndërtimi dhe Drejtues Teknik, Licencë në projektim, certifikatë trajnimi, librezë pune, diplomë, cv,*
1. *Kontratë Pune nr rep 1799 dhe nr kol 368 datë 22.07.2020 lidhur midis Punëdhënesit Shoqeria “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K dhe Punëmarrësit **Z. V.P me** objekt Z.Vladimit Pellumbime objekt, punësimi si **Drejtues Teknik** pranë kompanisë “47EK79&ILIRIADA P.K.S” Sh.p.k ( Licence nr T.1114/1 , Diplomë nr 3521 , Curriculum Vitae, Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit konsulent)*
  2. *Kontratë Pune nr rep 1798 dhe nr kol 367 datë 22.07.2020 lidhur midis Punëdhënesit Shoqeria “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K dhe Punëmarrësit Z. N..C me objekt,punësimi si **Drejtues Teknik** pranë kompanisë “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K. (Licence Gj.0321/1, Diplomë nr B-466, Corriculum Vitae, Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit konsulent)*
  3. *Kontratë Individuale Pune nr rep 5021 dhe nr kol 1532/2 date 02.10.2015 lidhur midis Punëdhënesit Z. Eduart Kujtim Cela dhe Punëmarrësit **Z K.C** me objekt të punojë si **Drejtues Teknik** pranë kompanisë “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K. ( Licence K.0310/7, Certifikatë nr 146, Diplome nr 2131-B, Deshmi Sektori Gjeoteknik, Corriculum Viate dhe Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit konsulent)*

4. *Kontratë Individuale Pune nr rep 704 dhe nr kol 204/1 datë 23.02.2018 lidhur midis Punëdhënësit “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K. dhe Punëmarrësit Z. E.C me objekt, punësimi si Drejtues Teknik pranë kompanisë “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K. ( Diplome nr 3311 , Curriculum Vitae, Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit konsulent)*
5. *Kontratë Individuale Pune nr rep 700 dhe nr kol 200/3 datë 22.02.2018 lidhur midis Punëdhënësit “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K. dhe Punëmarrësit Znj. F.B me objekt, punësimi si Drejtuese Teknike pranë Kompanisë “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K. ( Licence nr E.0204/3, Diplomë nr 4516-B, Deshmi Specializimi nr 21, Curriculum Vitae, Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit konsulent)*
6. *Kontraqtë Idividuale Pune nr rep 703 dhe nr kol 203/1 datë 22.02.2018 lidhur midis Punëdhënësit “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K dhe Punëmarrësit Znj. S.C me objekt, punësimi si drejtuese teknike pranë Kompanisë “47EK79&ILIRIADA P.K.S” SH.P.K (Licence nr M.1307, Diplomë nr 3546, Corriculum Vitae, Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit konsulent)*
7. *Kontratë Pune nr rep 253 dhe nr kol 33 datë 18.02.2020 lidhur midis Punëdhënësit Shoqëria SRP Albanian Engeneering dhe Punëmarrësit D.K me objekt Punësimi si Inxhinier Gjeolog ( Drejtues Teknik). (Licence nr GJ.0043/2 Curriculum Vitae )*

III.2.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimes mbi vlerësimin me pikë për stafin kryesor të propozuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, për specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me licencat profesionale në projektim, licenca në mbikqyrje, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit,

Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Referuar vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave rezulton se BOE ankimues lidhur me stafin e nevojshëm ka marrë një vlerësim prej 46.5 pikësh nga 50 pikë të mundshme, duke shtuar këtu edhe 10 pikë nga transferimi i njohurive në rastet kur nuk aplikohet.

Në rastin konkret, vlerësimi i dhënë nga specialistët e KVO lidhur me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me stafin e kualifikuar në fushën e projektimit dhe mbikqyrjes për BOE ankimues është i arsyeshëm dhe në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ky i fundit. Vlerësimi është shumë afër kufirit maksimal dhe në këtë kontekst, Komisioni gjykon se vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik është i mjaftueshëm ndërsa argumenti i operatorit ekonomik ankimues për një vlerësim maksimal nuk rezulton të jetë i bazuar. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, një vlerësim i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të mbetet i pandryshuar. Procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni gjykon se vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me stafin, duke përfshirë shumë elementë të tillë si numri i personelit, eksperiencia, profesionet, vitet e punës pranë shoqërisë ankimuese, etj. Komisioni gjykon se vlerësimi dhe gjykimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, në rastin konkret është i bazuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga BOE ankimues.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron

III.3. Gjithashtu në lidhje me metodologjinë e propozuar, BOE ankimues ka dorëzuar metodologjinë përkatëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik (151 fletë) në të cilën jepet një përshkrim i përfaqësues teknike, metodologjisë së hartimit të projektit për objektin e prokurimit, referencat teknike, objektivat, planin e punës dhe grafikun e e shërbimit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Në rastin konkret metodologjia e propozuar nga BOE ankimues në vetvete është një përshkrim i termave të referencës të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në këtë kontekst Komisioni gjykon se vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik është i mjaftueshëm ndërsa argumenti i operatorit ekonomik ankimues për një vlerësim maksimal për këtë komponent nuk rezulton të jetë i bazuar. Së pari, referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe ankesës së operatorit ekonomik, ky i fundit nuk ka dhënë asnjë shpjegim të detajuar mbi arsyet, veçanërisht ato në aspektin teknik se përsë nuk shpreh

dakordësi me vlerësimin e kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave apo duke analizuar veçanërisht në avantazhet e metodologjisë së propozuar nga ky i fundit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar konstatohet se metodologjia është e përgjithshme me terma reference të përgjithshme, duke përsëritur kështu detyrat e projektimit, pjesë të dokumenteve të procedurës së prokurimit. Në metodologjinë e theksuar bashkimi i konsulentëve nuk ka ofruar një metodologji të detajuar mbi ndërtimin e minimalisht dy variante për zgjerimin e aksit ekzistues si edhe nuk ka propozuar në metodologjinë e tij mundësinë e kryerjes së studimit për ndonjë aks të ri në zona të veçanta, siç është kërkuar në termat e referencës. Gjithashtu, krahasuar me detyrat e projektimit, termat e referencës së procedurës së prokurimit, nga ana e bashkimit të konsulentëve, nuk është analizuar metodologjia e kryerjes së shërbimit, veçanërisht në zonat e cilësuar problematike nga ana e autoritetit kontraktor, siç janë km 6+400 ku ndodhet një ure antike, apo km 14+400 deri km 15+100 ku rruga kalon në krahun e djathtë të dy ish tuneleve automobilistike, sot jashtë përdorimit. Gjithashtu, në metodologjinë e propozuar nuk është propozuar se si do të kryhet studimi për të ofruar zgjidhje për km 23+400 deri km 24+000 dhe km 53+800 deri në km 56+500, akse ku është kërkuar të studiohet mundësia e kalimit me by pass. Gjithashtu, metodologjia nuk jep detaje mbi mënyrën se si do të kryhet studimi, veçanërisht për lidhjen ku ffilon rruga në km 4+400 në dalje të qytetit të Elbasanit me By Pass të Elbasanit. Gjithashtu në metodologjinë e propozuar nuk ka një përmirësim të termave të shërbimit, ose propozime se si do të trajtohet çështja për akse të posacmë, si shembull km 4+900 (ku ndodhet një ure mbi përrua me prurje të medha inerte e cila bllokton rrugën shpesh here në këtë aks) për garantimin e funksionimit nga përmytjet sipas pikes 4/III të qëllimit të punës.

Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, një vlerësim i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të mbetet i pandryshuar. Procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri



## **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “47EK79”& Iliriada P.K.S shpk & “SRP Albanian Engeneering” shpk& “C.E.C” Group shpk, për procedurën e prokurimit, “Shërbim Konsulence”, me nr.REF-67204-07-28-2020, me objekt “*Studim Projektim zgjerim i segmentit rrugor, dalje Elbasan – Perenjas – Qafe Thane*” me fondin limit 53.369.587,32 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 18.09.2020 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1359 Protokolli, Datë 27.10.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**